



Buletini

- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial**
- * **Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore**
 - * **Aktivitetet tjera**

Shkurt 2020

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Program i Specializuar Krimi i organizuar dhe korrupsioni - Sesioni I

Më 04-05 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), organizoi trajnimin e specializuar me temën “Krimi i organizuar dhe korrupsioni -Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë lidhur me natyrën dhe format e korrupsionit si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me korrupsionin.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan veprat penale korruptive, korrupsioni sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e korrupsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit. Po

ashtu gjatë trajnimit u elaboruan instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës si dhe përfaqësues nga US DOJ, Ambasada Amerikane.



Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje

Më 06 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë: “Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrëseve rreth përdorimit të procedurave standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, zbatimit në mënyrë efikase dhe të drejtë të dispozitave lidhur me procedurën dhe afatet e vendosjes sipas kërkesave për urdhër mbrojtje si dhe të krahasojnë specifikat e dhunës në familje në procedurë civile dhe penale.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan këto çështje: dhuna në familje dhe urdhri për mbrojtje,

procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Në këtë trajnim janë diskutuar raste nga praktika gjyqësore, çështjet problematike dhe më komplekse të kësaj natyre, si dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave Themelore (divizioni civil) nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik Regjioni i Prishtinës

Më 12 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale implementuar nga CHECCHI and COMPANY realizuan trajnimin me temë “Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risitë që ka sjellë Ligji nr.06/-009 për Ndërmjetësimin, si dhe identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Në kuadër të këtij trajnimi janë elaboruar parimet e ndërmjetësimit, inicimi i procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura dhe obligimet e gjyqtarëve, zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit dhe efektet e saj, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurën e ndërmjetësimit.

Po ashtu është diskutua edhe referimi i lëndëve

në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin: gjyqtarët nga gjykatat themelore, nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Çështje Ekonomike, prokurorë të nivelit themelore, Bashkëpunëtorët Profesional dhe Ndërmjetësues.



Risitë në Ligjin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

Më 13 Shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), organizoi trajnimin me temë: “Risitë në Ligjin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja me risitë e Ligjit të Dhomës së Posaçme nr. 06/L-086, i cili ka hyrë në fuqi më 30 maj 2019.

Gjatë trajnimit u diskutua për risitë në ligjin e DHPGJS, duke bërë edhe krahasime të nevojshme me ligjin e vjetër. Për më tepër është diskutuar edhe për juridiksionin e Dhomës së Posaçme për rastet që paraqiten para saj dhe për kompetencën ekskluzive të përcaktuar me ligj. Si burim kryesor u theksua se është Ligji i ri i Dhomës së Posaçme dhe ligji i vjetër, por edhe praktika gjyqësore e krijuar tashmë nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së.

Në vazhdim u konkludua për paditësit dhe të paditurit në procedurat para Dhomës së Posaçme- Neni 6, ku është saktësuar se si të paditur në procedurat para Dhomës së Posaçme

janë edhe personat fizikë dhe juridikë apo autoritete publike. Kjo e ka qartësuar faktin se kush mund të jenë palë në procedurë, qoftë paditës apo i paditur. Me ligjin e vjetër ka munguar një përkufizim i këtillë dhe ka sjellë dilema në vendimmarrje.

Më tutje është diskutuar edhe për aktgjykimet, aktvendimet dhe ankesat, pjesa procedurale, organizimi, sesioni i përhershëm, afatet-kalimi i periudhave kohore, përfaqësimi në Dhomën e Posaçme, pranueshmëria e kërkesës/ankesës, përgjigja në padi-përgjigja e paditësit dhe kundërpërgjigja e të paditurit.

Metodologjia e zbatuar e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij aktiviteti ishin Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelore (divizioni civil si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Veprat penale të narkotikëve

Më 18 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë: “Veprat penale të narkotikëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore për luftimin e veprave penale të narkotikëve, cilat janë format apo veprimet që duhet ndërmarrë për hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale si dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë me qëllim që të zbatohen në mënyrë efektive mekanizmat përkatës.

Ky trajnim trajtoj veprat penale të narkotikëve të cilat bëjnë pjesë ndër krimet e shpeshta në jetën e përditshme, dhe të cilat atakojnë zhvillimin e shëndosh të shoqërisë. Me rastin e këtij trajnimi u potencua që veprat penale të narkotikëve si formë e kriminalitetit

manifestohen në forma të ndryshme si: blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge. Më tej objekt trajtimi dhe diskutimi ishin edhe prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike.

Vëmendje të veçantë iu kushtua padyshim praktikës gjyqësore me theks të veçantë vonesave kur kanë të bëjnë me përcaktimin e llojit të narkotikëve nga ana e ekspertëve, gjë që ka ndikim të drejtëpërdrejt në efikasitetin e hetimit dhe të gjykimin të këtyre veprave penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga nivelit themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës



Ndërmjetësimi në aspektin penal, civile dhe ekonomike Regjioni i Ferizajt

Më 19 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale, implementuar nga CHECCHI and COMPANY CONSULTING, realizuan trajnimin me temë “Ndërmjetësimi– Civile, Penale dhe Ekonomike”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risitë që ka sjellë Ligji nr.06/-009 për Ndërmjetësimin, si dhe identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Në kuadër të këtij trajnimi janë elaboruar parimet e ndërmjetësimit, inicimi i procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura dhe obligimet e gjyqtarëve, zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit dhe efektet e saj, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurën e ndërmjetësimit.

Po ashtu është diskutua edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga Regjioni i Ferizajt.



E Drejta në Gjykim të Drejtë – Neni 6 i KEDNJ

Më 20 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë: “E Drejta në Gjykim të Drejtë – Neni 6 i KEDNJ”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procesit gjyqësor.

Në pjesën e parë të trajnimit u diskutua rreth nocionit dhe kategorive të procesit të drejtë gjyqësor në kuptim të nenit 6 të KEDNJ si dhe standardet ndërkombëtare, në cilën fazë të procesit zbatohet neni 6, çfarë përgjegjësie kanë gjyqtarët, çfarë janë të drejtat civile dhe detyrimet, çfarë kuptohet me akuzën penale, natyrën e veprës penale.

E drejta për një proces të drejtë gjyqësor është parashikuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas përkufizimit të nenit të cekur më lartë me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij, civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij. Pra, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur

brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit.

Në vazhdim është diskutuar edhe për të drejtat e veçanta që zbatohen ndaj të miturit ku GJEDNJ ka njohur faktin se të drejtat e një procesi të drejtë gjyqësor sipas nenit 6 të KEDNJ zbatohen edhe ndaj procedurave të miturve, dhe çdo sugjerim që fëmijët e akuzuar të mos përfitojnë nga garancitë e procesit të drejtë, janë të papranueshme.

Ndërsa në pjesën e dytë është diskutuar për prezumimin e pafajësisë, e drejta për mjete juridike për Jurisprudencën e GJEDNJ-së në çështjet administrative.

Metodologjia e trajnimit ishte e kombinuar me metodat e shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik.

Përfitues të këtij aktiviteti ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit Suprem, të Apelit dhe nivelit themelore.



Kontestet tregtare - mos përmbushja e kontratave

Më 25-26 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), organizoi trajnimin me temë “Kontestet tregtare – mos përmbushja e kontratave”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me shkëputjen e kontratës dhe efektet e shkëputjes. Në ditën e parë të trajnimit u diskutua rreth kontratave, objekti i kontratave, elementet e kontratës, karakteristikat e objektit të kontratës, llojet e kontratave, oferta, mënyra e ofertimit si dhe kushtet e ofertës. Më tutje është folur edhe për kontratat absolutisht të pavlefshme si kontrata të cilat janë të lidhura në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperative dhe moralin, efekti juridik i kontratave nule, e drejta e kërkesës për vërtetimin e pavlefshmërisë, parashkrimi i të drejtave, nuliteti i pjesshëm, pavlefshmëria relative e kontratës, efekti juridik i kontratave relativisht të pavlefshme.

Në ditën e dytë është diskutuar për zgjidhjen e kontratës - heqja dorë nga kontrata në mënyrë të njëanshme, mos përmbushja e kontratës dhe pasojat juridike të shkëputjes, shkëputjen si një mënyrë për të përfunduar kontratën, kushtet për shkëputje dhe dështimi për të përmbushur detyrimet, përfundimi i kontratës si kusht për të pushuar kontrata, faji i debitorit, afati shtesë, kontratat me afat, njoftimi i debitorit, efekti juridik i përfundimit të kontratës, përgjegjësia për të metat materiale, si dhe interpretimi i kontratës.

Metodologjia e trajnimit ishte e kombinuar me metodat të shpjegimit, diskutime interaktive duke përfshirë shpjegime teorike si dhe është shoqëruar me raste hipotetike.

Përfitues të këtij aktiviteti ishin Gjyqtarë nga Departamenti për çështje Ekonomike nga niveli i Apelit dhe Themelor si dhe Zyrtar Ligjor.



Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik Regjioni i Gjilanit

Më 26 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale, implementuar nga CHECCHI and COMPANY CONSULTING, realizuan trajnimin me temë “Ndërmjetësimi– Civile, Penale dhe Ekonomike”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risitë që ka sjellë Ligji nr.06/-009 për Ndërmjetësimin, si dhe identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Në kuadër të këtij trajnimi janë elaboruar parimet e ndërmjetësimit, inicimi i procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura dhe obligimet e gjyqtarëve, zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit dhe efektet e saj, të drejtat dhe detyrimet e

palëve në procedurën e ndërmjetësimit.

Po ashtu është diskutua edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga Regjioni i Gjilanit

Hetimet financiare

Më 25-28 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) në bashkëpunim me UNODC, ka realizuar trajnimin me temë “Hetimet Financiare”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive rreth bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë me rastin e hetimit dhe gjykimit të pastrimit të parave dhe veprave penale që ndërlidhen me të.

Në kuadër të këtij trajnimi janë elaboruar: Burimet e informacionit, bashkëpunimi ndërkombëtar, mjetet dhe teknikat për analizën e të dhënave të shumta – detyrat dhe mjetet e përpunimit të të dhënave, mbledhja dhe analizimi i të dhënave financiare, transformimi i të dhënave financiare në prova, analizimi dhe

vizualizimi i lidhjeve, informacioni i burimit të hapur dhe provat, hetimi i skemave në shkallë të gjërë të pastrimit të parave të krimet tatimore dhe doganore dhe pastrimi i parave. Po ashtu, mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave financiare me qëllim që ato të dhëna financiare të kualifikohen si prova.

Gjatë trajnimit vëmendje i'u kushtua paraprakisht hetimit të skemave në shkallë të gjerë të pastrimit të parave, krimeve tatimore dhe doganore duke përfshirë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar që në praktikë është mesë i nevojshëm për t'i hetuar dhe gjykuar këto vepra penale të cilat përbëjnë rrezik për zhvillimin ekonomik të një vendi. Me rastin e këtij trajnimi përmes punës në grupe janë adresuar gjitha çështjet problematike duke zbrëthyer dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë fushë si dhe duke shkëmbyer praktikat më të mira në këtë drejtim.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët, prokurorët, stafi administrativ nga prokuroria, Policia e Kosovës dhe zyrtar nga NJIF, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.



Punëtori - Ndhimja e ndërsjellë juridike e Kosovës me vendet jo njohëse

Më 27 Shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë / EUO in Kosovo / EUSR, realizuan punëtorinë me temë “Ndhimja e ndërsjellë juridike e Kosovës me vendet jo-njohëse”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike me vendet Jo njohëse si dhe rolin e Bashkimit Evropian në ndihmën e ndërsjellë juridike, mënyrën e hartimit të kërkesave për ndihmë juridike, procedurat nëpër të cilat kalon ajo kërkesë gjatë analizimit të saj.

Në këtë punëtori u diskutua për rolin e BE’së në ndihmën e ndërsjellë juridike me vendet që nuk e njohin Kosovën, sistemin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me vendet jo-njohëse, bazën ligjore që EUO/EUSR ka që të jetë urë lidhëse për bashkëpunim juridike ndërkombëtar

me vendet jo- njohëse. Njëkohësisht u diskutuan edhe sfidat nëpër të cilat kalojnë institucionet gjegjëse sa i përket ndihmës së ndërsjellë juridike me vendet që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Po ashtu gjithanshëm u trajtuan dhe u analizuan problemet aktuale në praktikë, duke njohur dhe kuptuar më mirë rolin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Duke u bazuar në raste nga praktika gjatë punëtorisë u ofruan përgjigje në pyetjet dhe dilemat që hasen gjatë procedurës për ndihmë juridike me vendet Jo-njohëse si dhe bashkëpunimin e mirëfilltë që ka Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / EUO in Kosovo / EUSR.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarë, prokurorë, zyrtar nga Ministria e Punëve të Jashtme si dhe zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përmbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: gjithsej 13 sesione trajnuese janë realizuar nga modulet: Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare dhe Kodi i Procedurës Penale.

Në kuadër të nën modulit “KEDNJ” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese, ku prokurorët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja rreth: Këshillit të Evropës, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me theks të veçantë për nenin 2, nenin 4 i Protokollit 7 dhe Neni 5 par.1 të kësaj konventeje.

Nga nën moduli “E drejta e BE-së” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese, me anë të cilëve prokurorët zgjeruan njohurit e tyre lidhur me Strukturën e Traktateve, natyrën e kompetencave dhe parimet themelore të së Drejtës së Bashkimit Evropian, institucionet e Bashkimit Evropian dhe procesi i vendimmarrjes, katër liritë themelore në tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian si

dhe shqyrtimi Gjyqësor në Bashkimin Evropian.

Gjatë realizimit të trajnimit teorik prokurorët kanë realizuar dy (2) sesione nga nën moduli “Rregullat e komunikimit” ku pjesëmarrësit përfituan nga: Rregullat e komunikimit dhe rregullat e komunikimit të jashtëm dhe përvojat më të mira në mjedisin e punës.

Po ashtu nga nën moduli “Kontrolli dhe konfiskimi” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ndër të cilat janë trajtuar: Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, ngrirja sipas nenit 264 të KPP-së, ndalimi i pasurisë sipas nenit 266 të KPP-së, konfiskimi i përkohshëm sipas nenit 267 të KPP-së dhe përcaktimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dymbëdhjetë (12) ditë trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar.



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar



Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit shkurt ka zhvilluar aktivitete në drejtim të përmbushjes së programit trajnues, duke përfshirë trajnimin teorik dhe trajnimin praktik.

Në këtë periudhë janë realizuar 23 sesione trajnimi nga modulet: Kodi i Procedurës Penale dhe Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Në kuadër të nën modulit “Procedurat sipas mjeteve juridike” janë realizuar dy (2) sesione trajnues ku është trajtuar e drejta e të pandehurit për ankesë dhe vendimet e gjykatës pas përfundimit të seancës së kolegjit sipas kërkesesës për rishikimin e procedurës penale.

Nga nën moduli: “Procedurat e veçanta sipas KPPK-së” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë shtjelluar procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës dhe procedurat penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore si dhe zbatimi i procedurës për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Nga nën moduli “Kontrolli dhe konfiskimi” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese. Nga ky nën modul gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja lidhur me

kompetencën për urdhër kontroll, marrja e pasurisë së përfituar me vepër penale, kuptimi i sekuestrimit dhe konfiskimi si dy forma të marrjes së pasurisë së përfituar me vepër penale dhe konfiskimi sipas kompetencave të zgjeruara.

Po ashtu nga nën moduli: “Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit” u realizuan tre (3) sesione trajnuese ku pjesëmarrësit zgjeruan njohurit e tyre rreth urdhër arrestit dhe premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për paraqitjen më të afërt në stacionin policor si dhe arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi.

Gjatë realizimit të trajnimit teorik gjyqtarët kanë realizuar katër (4) sesione trajnuese nga nën moduli “Masat e hetimit dhe vëzhgimit”. Temat të cilat u trajtuan janë: masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, lloji i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe kuptimi i tyre, procedura për lëshimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Gjithashtu nga nën moduli “Ekspertiza dhe analiza” u realizuan katër (4) sesione trajnuese ndër të cilët gjyqtarët u informuan lidhur me ekspertizën si provë në procedurën penale, ekspertimi si veprim procedural në procedurë penale dhe nevoja e caktimit për ekspertim.

Në kuadër të nën modulit: “Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësorë” është realizuar një (1) sesion trajnues ku është diskutuar për caktimin e gjyqtarit për ta gjykuar çështjen dhe caktimin i shqyrtimit fillestar.

Gjithashtu një (1) sesion trajnues u realizua në kuadër të nën modullit: “Provat në procedurën penale” në të cilin u diskutua mbi marrjen e disa provave të rëndësishme, identifikimin dhe përmbledhjen e tyre.

Sipas kalendarit trajnues, gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar edhe trajnimin lidhur me “Zhvillimin e shkathtësive gjyqësore” ku janë trajtuar: Fjala hyrëse, kuptimi i marrjes së drejtpërdrejt dhe të tërthortë në pyetje dhe fjala

përfundimtare në të cilin janë zhvilluar shkathtësitë gjyqësore përmes rasteve praktike të simuluar nga vetë gjyqtarët e sapo emëruar.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 8 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur (37) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Protokolli, diplomacia dhe etiketa

Me 26-27 Shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë realizoi trajnimin dy-ditor lidhur me Protokollin, diplomacinë dhe etiketën për stafin administrativ të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Prokurorive të Shtetit nga rajone të ndryshme të vendit.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi i pjesëmarrësve për protokollin e nivelit shtetëror, ekzekutiv dhe institucional.

Në fokus të trajnimit ishin rregullat e përgjithshme të paraqitjes dhe organizimit të pritjes së delegacioneve, organizimit të ceremonive dhe ngjarjeve tjera institucionale dhe raportet diplomatike.

Rëndësi e veçantë gjatë trajnimit i është kushtuar edhe prezantimit të bazës ligjore për aplikimin e protokollit në segmentet e punës, që është Ligji për Protokollin e Shtetit, si dhe Konventa e Vjenës për Protokollin e vitit 1961,

dhe ajo për Marrëdhëniet konsullore e vitit 1963.

Pjesa e dytë e trajnimit u fokusua në pritjen e delegacioneve të ndryshme, implikimi i kulturave në rregullat protokollare, diplomacia, bazat e protokollit – qëndrimi hierarkik. Po ashtu trajnimi prezantoi këshilla lidhur me imunitetin dhe privilegjet, raporti i protokollit të shtetit në raport me institucionet dhe zyrat e jashtme, akreditimi i diplomatëve dhe stafit diplomatik, shtrirja e imunitetit dhe privilegjeve.

Trajnimi u realizua përmes prezantimeve, bashkëbisedimit dhe paraqitjes së skenarëve të ndryshëm varësisht nga temat.

Në fund u pajtuan lidhur me disa rekomandime për vazhdimësinë e këtij lloji të trajnimit, por edhe shtrirjen e tij edhe për kategori tjera përfituese.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi i SKPK-së dhe i prokurorive të shtetit përfshirë zëdhënës, zyrtarë për komunikim si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore

Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet

Më 19 Shkurt 2020. Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin me temë: “Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të zyrtarëve për ndihmë juridike falas në identifikimin e specifikave ligjore për përmbajtjen e mbrojtjes gjyqësore për secilën kërkesë si dhe të vlerësojnë dhe zbatojnë drejtë kushte ligjore për dhënien e mbrojtës gjyqësore në rastet e pengim posedimit.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan edhe

hartimi në strukturë dhe përmbajtje të rregullt për secilin lloj të vendimit gjyqësor varësisht nga lloji i kërkesës. Vëmendje të veçantë kishin rastet nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas lidhur me çështjet problematike të kësaj natyre, me theks të veçantë u diskutua lidhur me llojet e padive për mbrojtjen e pronësisë dhe paditë për mbrojtjen e servitutit dhe mbrojtjen nga pengimi i posedimi.

Përfitues në këtë trajnim ishin 20 zyrtarët e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas nga gjitha regjionet.



Shpërblimi i dëmit material dhe jo material

Më 20 Shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin me temë: “Shpërblimi i dëmit material dhe jo material”.

Qëllimi i realizimi të këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të zyrtarëve për ndihmë juridike falas lidhur me rastet specifike të shkaktimit të dëmit ndaj subjekteve të së drejtës si dhe në zbatimin e drejtë të procedurës gjyqësore për kompensimin e dëmit.

Në kuadër të trajnimit u shtjelluan procedurat

për kompensimin e dëmit jashtë procedurës gjyqësore ku pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas të diskutojnë lidhur me çështjet problematike të kësaj natyre, me theks të veçantë mbi: Shpërblimin e dëmit material dhe jo material nga polisa e sigurimit, kriteret për vlerësimin e dëmit dhe e drejta e rentës dhe vlerësimi i dëmit.

Përfitues në këtë trajnim ishin 20 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjione.



Aktivitetet tjera

Zgjidhja Alternative e Kontesteve - Ndërmjetësimi

Më 06 Shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale implementuar nga CHECCHI and COMPANY, realizuan punëtorinë “Zgjidhja Alternative e Kontesteve- Ndërmjetësimi”.

Punëtorja kishte qëllim kryesor avancimin e njohurive të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe avokatëve lidhur me mënyrat e zgjidhjes alternative të kontesteve me focus ndërmjetësimin.

Në pjesën e parë të punëtorisë u trajtuan: roli dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe avokatëve lidhur me referimin e rasteve në ndërmjetësim dhe përgjegjësitë që ka ndërmjetësuesi në raport me palët e përfshira në kontest gjatë mbajtjes së seancës së ndërmjetësimit. Në pjesën e dytë u trajtuan: marrëveshjet për ndërmjetësim dhe përmbarimi i këtyre marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjatë trajnimit u trajtua Ligji për Ndërmjetësimin, fushëveprimi i këtij ligji, funksionimi, procedura dhe organizimi i ndërmjetësimit, të drejtat, detyrat dhe

përgjegjësitë e ndërmjetësuesve me qëllim të lehtësimit të qasjes në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe kontesteve e cila promovon zgjidhjen miqësore të tyre.


Në vazhdim u theksua aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve, veçanërisht rëndësia dhe përparësitë e ndërmjetësimit, referimi i rasteve në qendrat e ndërmjetësimit dhe rolin e ndërmjetësuesve në harmonizimin e qëndrimeve tek palët e përfshira në kontest.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbrëthyer standardet dhe kërkesat ndërkombëtare dhe dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Pjesëmarrës në punëtori ishin gjyqtarët e gjykatës themelore të regjionit të Prizrenit, bashkëpunëtorët profesional, avokatët si dhe ndërmjetësuesit.



Punëtorja për rishikimin/hartimin e Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën e tetë të gjyqtarëve të sapo emëruar 2020/2021



Më 24-25 shkurt 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OBE-në është realizuar punëtorja për rishikimin/hartimin e Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën e tetë të gjyqtarëve të sapo emëruar 2020/2021.

Në kuadër të kësaj punëtorie është zhvilluar përmbajtja e Programit të Trajnimit Fillestar, hartimi i koncepteve, struktura, editimi dhe rishikimi i sesioneve trajnuese dhe shtimi i nën moduleve të reja me rëndësi që përkon me punën praktike të gjyqtarëve.


Gjatë realizimit të punëtorisë është diskutuar lidhur me metodologjinë e realizimit të

trajnimeve fillestare për trajnuesit dhe ndarja e grupeve sipas fushave adekuate. Më tej u potencua që gjatë trajnimeve teorike të trajtohen edhe raste nga praktika gjyqësore duke përpiluar aktgjykime me qëllim që gjyqtarët e sapo emëruar të kenë mundësi të ilustrojnë shembuj të ndryshëm dhe specifikojnë raste me të cilat do të përballen në punën e tyre si gjyqtarë.

Po ashtu gjatë punëtorisë pjesëmarrësit në cilësi të ekspertëve përveç rishikimit të programit të trajnimit fillestar dhe editimit të nën moduleve dhanë edhe propozimet e tyre që vlerësimi i gjyqtarëve për gjeneratën e (tetë) të bëhet në mënyrë periodike dhe me anë të lëmvive. Gjatë trajnimit teorik të merren parasysh rastet dhe jo diskutimi abstrakt si dhe gjatë realizimit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar të mos caktohen seanca gjyqësore.

Pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin: Trajnues dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë dhe përfaqësues nga OSBE.





Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>